

**William R. Hite, Jr., Ed.D.**  
Superintendent

7 Prill, 2022

Të Nderuar Prindër dhe Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

**Jam i lumtur të njoftoj se regjistrimi për Programet e Mësimit Veror të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias është tashmë i hapur për nxënësit nga kopshti deri në klasën e 12-të!** Programet e mësimit veror të këtij viti do të kombinojnë mësimin e bazuar në projekte me programimin jashtëshkollor për të ofruar mjedise argëtuese dhe të sigurta për studentët për të ruajtur dhe avancuar arsimin e tyre. Programimi veror gjithashtu ndihmon që të rinjtë tanë të mos harrojnë aftësitë kritike që mësuan gjatë vitit shkollor.

Programi gjithëpërfshirës ofron opsione për studentët e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias të të gjitha moshave – nga mësimi bazë deri te mundësitë e punësimit veror për nxënësit e shkollave të mesme (high school). Përveç kësaj, ne kemi bashkëpunuar me Qytetin e Filadelfisë për të ofruar përvoja jashtëshkollore pasdite, duke ofruar një program të plotë ditor për shumë nga studentët tanë. Për të mësuar më shumë rreth programeve të ndryshme që janë në dispozicion dhe për t'u regjistruar, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të programeve verore [këtu](#).

Të gjithë studentët aktualë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, përfshirë edhe ata që hyjnë në kopshtin e fëmijëve në vjeshtë, kanë të drejtë dhe inkurajohen, të regjistrohen për mësimin veror. Vendet në Programet e Mësimit Veror janë të kufizuara dhe plotësimi i një formulari regjistrimi nuk garanton regjistrimin. Regjistrimi do të jetë ,kush regjistrohet i pari, shërbehet i pari, bazuar në disponueshmërinë në çdo vendndodhje të programit. Familjet dhe studentët do të njoftohen për statusin e tyre të regjistrimit deri në fund të Majit.

Drejtorja mbetet e përkushtuar për të ofruar të drejtën e çdo studenti për një arsim të cilësisë së lartë. Pjesëmarrja në mësimin veror u jep studentëve një mundësi për të shijuar një përvojë verore pasuruese dhe kuptimplote.

Sinqerisht,



William R. Hite Jr., Ed.D.  
Superintendent  
Drejtorja Arsimore e Filadelfias

(Albanian)